

Në bazë të nenit 20, paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 15, dhe në lidhje me nenin 18, paragrafi (1), nënparagrafi 18 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), neneve 4, 6, 7, 9, 10 dhe 11 të Ligjit për donacione dhe sponsorizime në veprimtari publike („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.47/06, 86/08, 51/11, 28/14 dhe 153/15), neni 39, paragrafi (1), nënparagrafët 1 dhe 15 dhe neni 15, paragrafi (1), nënparagrafi 17 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, në lidhje me Kërkesën për donacion nga Institucioni Shëndetësor Publik – Spitali i specializuar për mjekësi paliative geriatrike „13 Nëntori“ Shkup për Projektin për efikasitet energjistik për ISHP SSMPG 13 Nëntori Shkup nr.05-205/4 datë 04.02.2025 (ark.nr.05-205/4 datë 04.02.2025) dhe Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë ark.nr.02-580/2 datë 10.02.2025, Drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, miratoi si vijon:

VENDIM
për dhënien e ndihmës financiare – donacion
Insitutit Shëndetësor Publik – Spitali i specializuar për mjekësi paliative
geriatrike „13 Nëntori“ Shkup

1. I ndahet ndihma financiare – donacion Institutit Shëndetësor Publik – Spitalit të specializuar për mjekësi paliative geriatrike „13 Nëntori“ Shkup (në tekstin e mëtejme: NSHP SSMPG 13 Nëntori Shkup), në shumë prej 1.000.000,00 (një milion) denarë për realizimin e „Projektit për efikasitet energjistik për ISHP SSMPG 13 Nëntori Shkup“, qëllimi i të cilit është instalim i sistemi të ri vetëqëndruar për ngrohjen e ujit nëpërmjet një sistemi kolektorësh diellor, i cili është energjikisht më efikas se sistemi që përdoret aktualisht nga spitali, më ekonomik dhe ekologjik, duke siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, nëpërmjet kujdesit më të mirë dhe higjienës personale për pacientët gariatrikë dhe palativë, reduktimin e faturave të energjisë elektrike të spitalit, si dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, zhvillimin e gjelbër, uljen e ndotjes së ajrit dhe ndikim në ndryshimet klimatike.

ISHP SSMPG 13 Nëntori Shkup obligohet që mjetet e dhëna financiare të përdoren ekskluzivisht për qëllimin e përcaktuar në paragrafin (1) të kësaj pike.

2. Mjetet financiare nga pika 1 e këtij Vendimi, parashihen në Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025 dhe të njëjtit do të paguhet në llogarinë e thesarit të Shëndetësisë: 10000000066005, Banka pranues: Banka Popullore e RMV-së, llogaria e përdoruesit buxhetor – përdorues i vetëm: 660250005953198, kodi i të ardhurave dhe programi: 744111 00.

3. Për dhënien e ndihmës financiare – donacion nga pika 1 e këtij Vendimi, lidhet Kontratë për donacion ndërmjet Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (në testin e mëtejme: Agjencia) dhe NSHP SSMPG 13 Nëntori Shkup, e cila hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dyja palët kontraktuese, dhe do të zbatohet pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik të Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë me miratimin e tij dhe do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

A r s y e t i m

Nga NSHP SSMPG 13 Nëntori Shkup, veprimtari bazë e të cilit është mbrojtja shëndetësore dhe sociale e të moshuarve dhe të rriturve, drejtuar Agjencisë me datë 04.02.2025, është dorëzuar Kërkesë nr.03-386 datë 03.02.2025 (nr.y në ark.05-205/4) për donacion të Projektit për efikasitet energjitik të NSHP SSMPG 13 Nëntori Shkup, bartës dhe partner i të cilit është Shoqata për mbështetjen e Pacientëve Palativ dhe familjeve të tyre PALIUM. Si Shtojcë e Kërkesës në fjalë është dorëzuar: Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Shoqatës për mbështetjen e pacientëve palativ dhe familjeve të tyre PALIUM Shkup (PALIUM Shkup) dhe NSHP SSMPG 13 Nëntori Shkup nga viti 2022, Paraqitja tabelare e energjisë elektrike të shpenzuar të shprehur në kw/h gjatë ditës sipas muajve për vitin 2024, Draft-kalkulim për instalimin e sistemit të kolektorëve diellor në dy objektet e spitalit nga një firmë (kompani) e specializuar për këtë qëllim Shoqëria për prodhim, tregti, hotelieri, transport dhe shërbime FRI INSTAL SHPKNJP eksport-import Shkup, si dhe Projekt për efikasitet energjitik me instalimin e kolektorëve diellorë në NSHP SSMPG 13 Nëntori Shkup nga data 28.12.2024.

Me Projektin (kërkesë për donacion) propozohet instalimi i sistemit të ri të vetëqëndrueshëm për ngrohjen e ujit përmes sistemit të kolektorëve diellorë në dy objektet e NSHP SSMPG 13 Nëntori Shkup“ (Geriatrik dhe Sju Rajder në komunën Gjorçe Petrov), i cili kujdeset për 195 pacentë geriatrikë dhe 75 pacentë paliativ, për të cilët çdo ditë kujdesen 110 kujdestar (që nënkupton dhe kujdesin për higjenë personale). Sistemi i ri i ngrohjes në pajtim me dokumentacionin e projektit do të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përmes kujdesit më të mirë dhe higjenës personale për pacentët, përmes kujdestarëve, me praninë e vazhdueshme të ujit të ngrohtë. NSHP SSMPG 13 Nëntori Shkup, aktualisht përdor një sistem për ngrohjen e ujit, që është 60 vjet i instaluar, dhe i njëjti gjeneron fatura të larta për rrymë elektrike, kështu që përmes sistemit të ri që është energjikisht më efikas, më ekonomik dhe më ekologjik, do të sigurojë uljen e faturave të energjisë elektrike të spitalit, si dhe mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit jetësor duke përdorur burime të rinovueshme të energjisë, zhvillimin e gjelbër, uljen e ndotjes së ajrit dhe ndikim në ndryshimet klimatike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 20, paragrafi (1), nënparagrafët 1 dhe 15, dhe në lidhje me nenin 18, paragrafi (1), nënparagrafi 18 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, nenet 4, 6, 7, 9, 10 dhe 11 të Ligjit për donacion dhe për sponsorizim në veprimtari publike, neni 39, paragrafi (1), nënparagrafët 1 dhe 15 dhe neni 15, paragrafi (1), nënparagrafi 17 të Rregullores së Punës së Agjencisë dhe Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë, ark.nr.02-580/2 datë 10.02.2025, Drejtori i Agjencisë miratoi vendim për dhënien e ndihmës financiare – donacion për NSHP SSMPG 13 Nëntori Shkup, në shumë prej 1.000.000,00 (një milion) danarë. Në pajtim me këtë vendim, NSHP SSMPG 13 Nëntori Shkup, obligohet t'i përdor mjetet e dhëna financiare ekskluzivisht për qëllimin e përcaktuar në pikën 1 paragrafi (1). Mjetet e dhëna financiare nga pika 1 e këtij Vendimi, parashihen në Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2025, dhe do të paguhen në Llogarinë e Thesarit Shëndetësor: 10000000066005, banka pranues: Banka Popullore e RMV-së, llogaria e përdoruesit buxhetor – përdorues i vetëm: 660250005953198, kodi i të ardhurave dhe programi: 744111 00.

Për dhënien e ndihmës financiare, lidhet Kontratë për donacion ndërmjet Agjencisë dhe NSHP SSMPG 13 Nëntori Shkup, e cila hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dyja palët kontraktuese, dhe do të zbatohet pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik nga Ministria e Drejtësisë e RMV-së.

Ky Vendim hyn në fuqi me miratimin e tij dhe do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë.

Bazuar në sa më sipër u miratua vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Drejtori,**

Dr. Zoran TRAJÇEVSKI